



Kaçanik, 14/04/2025

Data	14.04.2025	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
	09-104/02-	8184/25	

Duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Kaçanikut me numër 01-104/02-2830/25 të datës 03.02.2025, rregullorës MF-NR-04/2017 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Rregullorës Komunale Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall këtë :

Thirrje Publike

Për mbështetje financiare, për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në promovimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2025

I. Komuna e Kaçanikut /Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës e që veprojnë në Komunën e Kaçanikut, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe Sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet sipas kësaj thirrje publike.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në Kulturë dhe Sport .

3. Organizatat jo qeveritare mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në promovimin e Kulturës dhe Sportit përmes aktiviteteve si më poshtë:

✚ NË FUSHËN E KULTURËS

- Promovimi i trashëgimisë kulturore
 - Përkrahje për OJQ-të duke u bazuar në planprogramin e DKRS për vitin 2025 në aktivitetet si : Aktivitete kulturore për shënimin e datave të rëndësishme në komunën tonë etj...

✚ NË FUSHËN E E SPORTIT

- Përkrahja e klubeve publike sportive;
- Avancimi i aktiviteteve në klubet sportive dhe masovizimi i sportit për të rinjë ;
- Përkrahja për klubet, që funksionojnë në komunën e Kaçanikut, do të mbështeten bazuar në realizimin e suksesshëm të aktiviteteve/programeve të tyre rinore e sportive në vitet paraprake dhe planprogramit të tyre të punës për vitin 2025.
- Përkrahje për OJQ-të duke u bazuar në planprogramin e DKRS për vitin 2025 në aktivitetet rinore e sportive për shënimin e datave të rëndësishme në komunën tonë etj...

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes publike në fushën e Kulturës dhe Sport është **27,326.00 €**

4.1 Kulturë 2,500.00 €

4.2 Rini dhe Sport, 24,826.00 €

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është **15** ditë pune dhe përfundon me datë **07.05.2025**

- OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti **2** projekte në kuadër të kësaj thirrje (OJQ që aplikon me më shumë se dy projekte nuk do të mirret për vlerësim të mëtutjeshëm)
 - Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të që mund të alokohet për një projekt është 500 € ndërsa shuma maksimale 6000 €.
 - Periudha e zbatimit të projektit është deri në përfundimin e vitit 2025.
 - Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, e të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut
 - Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë organizatat sportive që veprojnë sipas Ligjit për Sport LIGJI NR. 08/L-277.
 - OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Kulturës, dhe Sportit .
 - OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit .
 - OJQ-të duhet të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare publike .
 - Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi **përgjegjës në OJQ** dhe **menaxheri i projektit** nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.
 - Ojq-të përfituese të subvencioneve gjatë këtij viti nuk kanë të drejtë aplikimi në këtë thirrje .
6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit (shkarko aplikacionin <http://kk.rks-gov.net/kacanik>) në faqen e internetit të komunës së Kaçanikut. *Kliko : SHPALLJET -----APLIKACIONET*
7. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: hafize.sallahi@rks-gov.net

Kërkesës së aplikimit duhet ti bashkangjiten edhe dokumentet :

- Certifikata e numrit të regjistrimit dhe numrit fiskal të organizatës ;
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kaçanik;
- Vërtetimi i licencimit pranë Federatës Përkatëse (vetëm për organizatat sportive);
- Letërnjoftimi i personave (aplikantit) që përfaqëson organizatën dhe menagjerit të projektit ;
- Xhirologjaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës, më i ri se 3 muaj ;
- Dëshmi se nuk ka organizata obligime ndaj ATK-së;

Dokumentacioni i cili shkarkohet nga ëeb faqja e Komunës së Kaçanikut :

1. Formullari i aplikacionit për projekt programin (Formulari F9)
2. Formullari i propozim buxhetit (Formulari F10)
3. Formën e deklaratës për mungesën e financimit të dyfishtë (Formulari F11)
4. Forma e deklarimit të programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (Formulari F13)
5. Forma e Deklaratës së partneritetit, nëse është e aplikueshme (Formulari F12)
6. Deklaratë e aktiviteteve të kontraktorit të përmendura në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e projektit, nëse është e aplikueshme (Formulari F14).
7. **Dokumentacioni i aplikimit duhet të printohet dhe të nënshkruhet nga menagjeri i projektit dhe përfaqësuesi i OJQ-së dhe të vuloset . Ky dokumentacion i dorzuar në tërësi skanohet dhe dorzohet bashkë me gjitha dokumentet përcjellëse në CD ose USB (obligative)**

Komuna e Kaçanikut do të formojë një komision profesional për vlerësimin e projekteve dhe rezultatet do të jenë publike për secilën OJQ aplikuese të detajuara sipas rregullorës MF-NR-04-2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregullorës Komunale Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Data e aplikimit është nga 15.04.2025 deri më 07.05.2025

Dorëzimi i aplikacioneve : Objekti i Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës është i detajuar në Udhëzimet për aplikuesit(lu lutem konsultone Udhëzuesin për aplikim). Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftesë publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Hafize Sallahi –Drejtoreshë

